

VITE NË VIJIM



colorWAVE seria T

Një printer me ngjyra mbi të cilin
mund të mbështeteni

Canon

VITE NË VIJIM NJË PRINTER ME NGJYRA MBI TË CILIN MUND TË MBËSHTETENI



¹ Të gjitha krahasimet e performancës së produktit i referohen serive të mëparshme të printerëve colorWAVE, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

² Jetëgjatësia ekonomike e pritshme e serisë colorWAVE është 7 vite duke u bazuar në të dhënat e shërbimit të Canon.

colorWAVE seria T ju sjell teknologji të besuar me fuqi printuese të gjeneratës së fundit. Është një printer mbi të cilin mund të mbështeteni për vitet në vijim.

Gjenerata e fundit e printerëve colorWAVE

Kur u hodhën në treg në vitin 2009, printerët colorWAVE ofronin produktivitet të qëndrueshëm dhe të besueshëm të printimeve me cilësi të lartë dhe një filozofi dizajni të ndërtuar për jetëgjatësi.

Tani, duke u bazuar në mbi një dekadë suksesi si lider në treg, gjenerata e gjashtë zhvillon akoma më tej konceptin e colorWAVE. Për përdoruesit e skicave dhe dizajneve teknike ofron:

- Lehtësi përdorimi akoma më produktive¹
- Veçori të përditësuara të sigurisë së IT-së për jetëgjatësinë ekonomike të printerit²
- Mbështetje për nismat tuaja të qëndrueshme të biznesit

Për mjedise korporatash, zyra arsimit dhe zyra qeveritare


Përdoruesit për herë të parë do të vlerësojnë mundësinë e kombinimit të të gjitha detyrave të tyre në një pajisje të vetme për printim, skanim dhe fotokopjim me ngjyra dhe njëngjyrëshe (bardhezi). Ata mund të mbështeten në përdorimin intuitiv që mësohet shpejt dhe në printimin produktiv e të pambikëqyruar të kompleteve të mëdha të printimit. colorWAVE seria T është gjithashtu e përshtatshme për veprimtaritë e printimit të brendshëm të kompanive që po mendojnë të zgjerojnë shërbimet dhe zbatimet e tyre.



Dyqane
printimi
profesional



Arsim



Zyra qeveritare



DIZAJNONI,
KRIJONI DHE
FORMËSONI
BOTËN TONË

Për reprografët dhe dyqanet e printimit

Zgjeroni biznesin tuaj me serinë T. Kontrolluesi i integruar POWERsync⁺ ju lejon të merrni përsipër, si skicat dhe dizajnet e ndërlikuara me ngjyra, ashtu edhe posterët, prezantimet dhe zbatime të tjera me ngarkesë të arteve grafike. Ofroni rezultate të cilësisë së lartë në lloje të ndryshme materialesh, duke përfshirë letrën me dhe pa veshje.

7 PËRFITIME TË SERISË T PËR JU

Printer rezistent me
ngjyra


1


Filozofi dizajni
profesional

2

Përdorim i lehtë dhe
produktiv

3





4 Fluks pune i thjeshtuar

5 Veçori të sigurisë së IT-së

6 Mbështetje për nisma të qëndrueshme të biznesit

7 Sportel unik

ÇDO DETAJ KA RËNDËSI

PRINTER REZISTENT ME NGJYRA PËR VITET NË VIJIM

Bizneset funksionojnë më mirë me mendjen e qetë. colorWAVE seria T është projektuar për t'ju ofruar besueshmëri dhe kohë funksionimi të pandërprerë, pa qenë nevoja për mirëmbajtje të përditshme.

Është projektuar për të ofruar cilësi të vazhdueshme printimi, si me kalimin e kohës, ashtu edhe në makineri të ndryshme. Është një makineri e fuqishme për biznesin tuaj me teknologji që ka qenë në përdorim për një kohë të gjatë duke përdorur pjesë me jetëgjatësi të lartë përdorimi dhe me një numër minimal pjesësh të konsumueshme. Të gjitha të mbështetura nga organizata e shërbimit të Canon, partneri juaj afatgjatë.



**MBËSHTETUR
NË NJË DIZAJN
SOLID**

Përdoruesi në qendër të çdo vendimi mbi dizajnin

colorWAVE është dizajnuar për t'u zhvilluar bashkë me biznesin tuaj. Për shembull, dosjet në serinë palosëse janë plotësisht të përputhshme me të gjithë printerët tanë colorWAVE. Kështu që kur të blini një printer të ri, mund të përdorni dosjen ekzistuese, ose të vazhdoni të përdorni printerin tuaj ekzistues kur blini një dosje të re. Kjo ju ndihmon të mbron investimet tuaja në të ardhmen.

Përfitimet e lirisë së përdorimit

Me colorWAVE seria T, mund të mbështeteni në një gamë të gjerë përdorimesh. Gama e gjerë e materialeve mbështet çdo gjë, që nga skicat dhe dizajnet e cilësisë së lartë deri te posterët, prezantimet dhe zbatimet e tjera me ngarkesë të arteve grafike.

- Printim në materiale më të trasha për t'ju ndihmuar të kryeni më shumë punime dhe të ktheni më shpejt investimin falë teknologjisë MediaSense
- Printime me tharje në çast pa hije dhe me detaje të përsosura në një gamë të gjerë materialesh, nga letra e hollë pa veshje deri te vinili falë teknologjisë fleksibël të printimit CrystalPoint



FILOZOFI DIZAJNI PROFESIONAL PËR VITET NË VIJIM

Ne kemi udhëhequr arkitektë, dizajnues dhe inxhinierë drejt mënyrave më të mira të printimit të skicave dhe dizajneve teknike për më shumë se 85 vjet¹. Ne jemi edhe një prej kompanive lider të prodhimit në botë, me përvojë të lartë në dizajn dhe inxhinieri.

¹ Canon u themelua në vitin 1937, më shumë se 85 vite më parë. Océ, pjesë e Canon, ka qenë aktive në printimin e skicave dhe dizajneve teknike që në vitet 1920. Océ ishte furnizuesi lider në botë i printimeve diazo. Më pas shtroi rrugën drejt elektrofotografisë analoge dhe dixhitale, e më vonë asaj me bojë. Në vitet 1980, Océ ishte lider botëror në tregun e printimit të dokumenteve teknike. Sistemet Océ përdorshin në shumë nga kompanitë më të mëdha të prodhimit, ndërtimit, infrastrukturës dhe shërbimeve utilitare, si edhe në printerët e punëve që furnizonin këto industri.



**85+ VITE
EKSPERTIZË
NË PRINTIM**

Ne e dimë se si profesionistët krijojnë dhe përdorin vizatimet dhe dizajnet teknike. Seria T është projektuar nga profesionistët për profesionistët:

- Teknologji e provuar tek e cila mund të mbështeteni
- Dizajn printeri i fortë si shkëmbi
- Plan i veçorive të sigurisë së IT-së për të mbështetur sigurinë informatike të printerit sot dhe në të ardhmen
- Dizajn i qëndrueshëm që ju ndihmon në mbështetjen e nismave tuaja të qëndrueshme të biznesit
- Ndërfaqe intuitive dhe praktike në përdorim për t'u ardhur në ndihmë përdoruesve në prodhimin e printimeve të sakta që me herën e parë

Fuqia e vërtetuar e CrystalPoint

Në thelb të serisë colorWAVE T ndodhet teknologjia jonë me besueshmëri të lartë, CrystalPoint, me më shumë se 15 vjet performancë të vërtetuar në treg. TonerPearls e saj të veçantë nxehen dhe hidhen me shpejtësi mbi material me saktësi ekstreme për cilësi të qartë printimi.

Printimet e prodhuara me colorWAVE janë të forta, rezistente ndaj ujit dhe gërvishtjeve dhe nuk kanë nevojë për laminim. Teknologjia CrystalPoint me tharje në çast mundëson stivim ose palosje të menjëhershme të produkteve të realizuara. Linjat e imëta janë të mprehta për lexueshmëri të lartë. Aplikimi i bojës është uniform. Gjithashtu mund të printoni mbi një gamë të gjerë materialesh, madje edhe mbi materiale pa veshje, duke pasur parasysh opsionet më të mira për koston.

Teknologjia e qëndrueshme e printimeve shumë-kalimëshe CrystalPoint printon çdo detaj me saktësi të lartë, duke bërë serinë T ideale për skicat e detajuara teknike si edhe posterët, prezantimet dhe zbatimet e tjera me ngarkesë të arteve grafike.

PËRDORIM I LEHTË DHE PRODUKTIV PËR VITET NË VIJIM



NDËRFAQE
INTUITIVE

colorWAVE seria T ofron përdorim të lehtë dhe produktiv për pothuajse çdo lloj detyre, që nga një printim i shpejtë deri te detyrat më të ndërlikuara dhe grupet e dokumenteve. Së bashku me PRISMA Tech Suite, ai është një printer me ngjyra ku mund të mbështeteni për vitet e ardhshme.

Printim vërtet me vetëm një “buton të gjelbër”

colorWAVE seria T tejet produktiv ndihmon përdoruesit tuaj të kursejnë kohë dhe shpejton procesin e dizajnit. Edhe për përdoruesit për herë të parë, ndërfaqja intuitive redukton kohëzgjatjen për ta mësuar dhe ndihmon në parandalimin e printimeve të gabuara ose vonesave. Thjesht shtypni butonin e gjelbër!

Përdorimi është intuitiv edhe me shikim të parë dhe është projektuar në parimin e praktikitetit në përdorim dhe parimin "tërhiq dhe lësho". Mund të dorëzoni skedarët drejtpërdrejt nga shfletuesi i internetit dhe të printoni drejtpërdrejt nga aplikacionet e përputhshme, me një komplet intuitiv drajverësh.

Pamjet paraprake të sakta që paraqesin me përpikëri atë që do të printohet ju lejojnë të bëni një inspektim vizual të shpejtë ndërkohë që jeni duke përzgjedhur cilësimet e printimit. Kjo mund të parandalojë gabimet e printimit dhe shpërdorimin e kohës, tonerit dhe letrës.

Nëse keni shumë punë standarde ose përsëritëse, mund të krijoni lehtësisht një shabllon të specializuar të punës për të përshpejtuar punën herën tjetër.

Për sa u përket drajverëve, Canon ka menduar për ju. Driver Select, drajveri i printerëve me format të madh për Windows, është projektuar për të reduktuar gabimet dhe për t'ju ndihmuar të jepni rezultate të sakta që me herën e parë me anë të funksioneve të qarta dhe praktike në përdorim. Driver Express mundëson printimin e skedarëve PostScript nga Mac dhe Windows.

colorWAVE seria T është projektuar që të funksionojë pothuajse vetë. Por nëse ka nevojë për vëmendjen tuaj, do të mund ta shikoni menjëherë falë dritës së re sinjalizuese tepër të dukshme.

Veçori të fuqishme dhe inteligjente automatizimi

Një mënyrë shumë e mirë për të qenë produktiv është të automatizoni proceset. colorWave seria T ka shumë cilësime dhe sisteme të automatizuara që ju kursejnë kohë, duke reduktuar printimet e gabuara dhe shqetësimet për vitet në vijim.

Cilësimet e automatizuara të printimit dhe sugjerimet e modalitetit të printimit ofrojnë printime të jashtëzakonshme me vetëm disa klikime të një butoni. Gabimet e parandalueshme të printimit mund të jenë diçka e së kaluarës me anë të pamjeve paraprake automatike që paraqesin me përpikëri atë që do të printohet.

Teknologjia PAINT e spërkatësve të automatizuar kompenson defektet e spërkatësës edhe gjatë printimit, duke siguruar rezultate të cilësisë së lartë dhe duke shpëtuar printime që përndryshe do të kishin dështuar. Veçoritë inteligjente të përdorimit të materialeve si p.sh. zbulimi automatik i gjerësisë së materialeve, zbulimi automatik i materialeve të mbetura dhe ndërrimi automatik i rullit ju ndihmojnë të prodhoni printime pa gabime me shumë pak ndërhyrje.



NJË KATALOG PËR ÇDO NEVOJË

PRODUKTIVITET

colorWAVE

T60

4 A1
p/m

4 rula

4 mo-
dal-
itete
printi-
mi



colorWAVE seria T është e disponueshme në dy modele.

colorWAVE T60 është ideal për printim për herë të parë pa shqetësime. colorWAVE T65 ofron modalitete shitesë të cilësisë për përdoruesit që kërkojnë cilësi më të lartë si edhe kapacitet më të lartë materialesh dhe akoma më shumë fleksibilitet materialesh.

colorWAVE

T65

4 A1
p/m

6 rula

9 moda
litete
printimi



FLUKS PUNE I THJESHTUAR PËR VITET NË VIJIM


Siguria SMARTshield ofron mbrojtje

Mbroni informacionet tuaja me vlerë në të gjitha fazat e procesit të printimit.




Paneli i përdoruesit ClearConnect

Printoni, fotokopjoni dhe skanoni me panelin e përdoruesit me prekje të shumëfishtë, po aq thjesht sikur të përdornit një tablet.




Publisher Express

Dorëzoni lehtësisht punët tuaja të printimit me anë të internetit, pavarësisht llojit të shfletuesit të internetit.



POWERsync⁺

Realizoni produkte cilësore me produktivitet të lartë, duke përdorur ndërfaqen tonë intuitive praktike në përdorim.




Publisher Mobile

Dorëzoni punët e printimit me anë të aplikacionit tuaj celular në telefonat IOS dhe Android.




Drajverët e printerit

Printoni me efikasitet dhe efektshmëri nga çdo aplikacion me drajverët tanë praktikë të printerëve.




Arkitekturë e hapur

Integroni lehtësisht në aplikacionet e menaxhimit të printimit, të tilla si uniFLOW¹ falë kontrolluesit tonë POWERsync⁺.



¹ Softueri bazë uniFLOW përfshihet si standard.
Funksion opsional shtesë i disponueshëm për t'u blerë.
Konsultohuni me përfaqësuesin tuaj të Canon.

Ne nuk jemi vetëm një nga liderët e tregut të printerëve me performancë të lartë. Jemi gjithashtu zhvillues të mirënjohur të kontrolluesve dhe softuerëve të fluksit të punës që i pajisin arkitektët, dizajnuesit dhe inxhinierët me mjetet e nevojshme të punës së tyre.



PRISMA Tech Suite

Krijoni projekte mbresëlënëse ndërkohë që jeni në kontroll të printerit tuaj me anë të zgjidhjeve të fuqishme të fluksit të punës që janë projektuar për t'ju ndihmuar me përdorimin e përditshëm të printerit.



PRISMAproduce Tech

Kompozoni, menaxhoni dhe dorëzoni komplete të ndërluara dokumentesh nga shfletuesi juaj i internetit te një ose më shumë printerë njëkohësisht.



PRISMAlytics Dashboard

Merrni përmbljedhje gjithëpërfshirëse për të monitoruar dhe maksimizuar prodhimtarinë e punimeve tuaja të printimit me këtë mjet të sigurt të menaxhimit të informacionit të bazuar në renë kompjuterike.



PRISMAlytics Accounting

Mblidhni të dhëna për tarifimin e kostove dhe monitorimin e përdorimit me këtë mjet raportimi të bazuar në renë kompjuterike.



PRISMAservice

Maksimizoni kohën e funksionimit me anë të metodologjisë CARE

- Mblidhni të dhënat në distancë
- Analizoni të dhënat
- Riparoni printerët me anë të ndihmës në distancë
- Vlerësoni për përmirësim të vazhdueshëm

Projektuar për proceset tuaja të përditshme

Printerët colorWAVE seria T janë krijuar për t'u përshtatur me proceset që kryeni në përditshmërinë tuaj. Dorëzoni punët nga kudo nga një gamë e gjerë pajisjesh. Mblidhni printimet e përfunduara ku dhe kur ju nevojiten. Seria T ju kursen kohë, shpejton proceset e dizajnit dhe shkurton kohëzgjatjen e realizimit të punës.

Gati kur ju jeni gati

Fluksi i thjeshtuar i punës nis me funksionin e ndezjes në distancë. Ju ndihmon të siguroheni që colorWAVE është gati kur ju të shkoni te printeri. Kontrolluesi i gjeneratës së fundit me performancë të lartë POWERSync⁺ përdor softuerin e fundit Microsoft Windows në harduer më të shpejtë me më shumë kapacitet memorieje¹ për përpunim pune të shpejtë si rrufe.

Po punoni me materiale origjinale me pasaktësi?

Pa problem. Teknologjia e skanimit Image Logic ju ndihmon t'i ktheni ato në fotokopje dhe skanime të përsosura. Me anë të mbështetjes së gjerë për softuerët e drajverëve si Driver Select dhe Driver Express Postscript, mund të printoni nga çdo aplikacion në Windows ose Apple iOS.



**GATI KURDO
QË TË JENI JU**

¹ Të gjitha krahasimet e performancës së produktit i referohen serive të mëparshme të printerëve colorWave, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

² Opsionale.

Prakticitet ergonomik

Dizajni me përdoruesin në qendër i colorWave seria T nuk do të kalojë pa rënë në sy. Ne vendosim përdoruesin në qendër të çdo vendimi që marrim mbi dizajnin. Mund të mbështeteni në përdorimin intuitiv që mësohet shpejt si edhe në printimin produktiv dhe të pambikëqyrur të completeve të mëdha të printimit.

Dizajni ergonomik colorWave seria T ju ndihmon të punoni pa mundim, tani dhe në vitet në vijim. Funkcionet e përdorimit të materialit dhe zëvendësimit të rullit si p.sh. zbulimi automatik i gjerësisë, zbulimi automatik i materialeve të mbetura dhe ndërrimi automatik i rullit ju ndihmojnë të prodhoni printime pa gabime me shumë pak ndërhyrje.

Mund të rrotulloni dhe të anoni ndërfaqen e përdoruesit për të kontrolluar printerin nga pozicioni më i rehatshëm dhe praktik. Me anë të mbledhjes fleksibël të printimeve, mund të zgjidhni ku doni të mbledhni printimet tuaja: nga sirtari i sipërm, nga Stacker Select² ose dosja².

Ne investojmë shumë në kërkime lidhur me përdoruesit për të përcaktuar funksionet më të mira të printerëve dhe fluksit të punës për përdoruesit profesionistë. Këto njohuri janë integruar në serinë T për t'ju ndihmuar të përshpejtoni proceset e dizajnit dhe për të shkurtuar kohëzgjatjen e proceseve. Jemi të përkushtuar ndaj zhvillimit të vazhdueshëm. colorWAVE seria T është një printer me ngjyra mbi të cilin mund të mbështeteni për vitet në vijim.

**PËRSHPEJTONI
PROCESET E
DIZAJNIT**



VEÇORI TË SIGURISË SË IT-SË PËR VITET NË VIJIM

Autorizimi

Kufizoni aksesin e paautorizuar në dosjet konfidenciale.

Hapësirë ruajtëse e sigurt

Mbroni të dhënat konfidenciale të printerit nga vjedhja ose rrjedhja aksidentale e të dhënave.

Dorëzim i sigurt

Mbroni të dhënat dhe kredencialet e përdoruesit kur dërgoni skedarë në printerin tuaj nga cilado pajisje.

¹ Jetëgjatësia ekonomike e pritshme e serisë colorWave është 7 vite duke u bazuar në të dhënat e shërbimit të Canon.

Më shumë se kurrë më parë, ju duhet të mbroni infrastrukturën tuaj të IT-së dhe asetet e të dhënave me vlerë nga aksesi i paautorizuar. Me disa shtresa të veçorive të sigurisë, seria colorWAVE T është një printer ku ju mund të mbështeteni pa u shqetësuar për vitet e ardhshme.

Plani ynë për veçoritë e sigurisë së IT-së mbështet sigurinë e IT-së së printerit për jetëgjatësinë e tij ekonomike¹. Duke u bazuar në cilësimet e përzgjedhura të administratorit të sistemit, do të merrni automatikisht njoftime kur disponohet një korigjim i ri sigurie Microsoft. Administratorët tuaj mund t'i instalojnë ato nga kompjuterët e tyre, në mënyrën dhe kohën kur dëshirojnë.

Parandalimi i hakimit

Parandaloni aksesin e padëshiruar në printer nga jashtë organizatës tuaj.

Garantoni sigurinë tuaj tani dhe në të ardhmen

Mbajini të dhënat dhe rrjetin tuaj të sigurt tani dhe në të ardhmen me SMARTshield.



**PARANDALIMI
I HAKIMIT**

JU NDIHMOJMË
TË MBRONI TË
DHËNAT TUAJA

NJË VËSHTRIM NGA AFËR I VEÇORIVE TË SIGURISË SË IT-SË TË SERISË T



Projektuar me në fokus për sigurinë e IT-së

Skedarët konfidencialë dhe të kufizuar mund të mbrohen nga aksesit i padëshiruar me anë të niveleve të shumëfishta të masave të sigurisë, si p.sh. kredenciale domeni, identifikim i përdoruesit me LDAP dhe skedarë printimi të mbrojtur me fjalëkalim.

Mund të caktoni një fjalëkalim ose kod për çdo punë për t'ju ndihmuar të mbroni skedarët e printimit me informacione delikate. Kjo mund të ndihmojë në parandalimin e printimeve aksidentale nga përdorues të paautorizuar, në mënyrë që printimet të mos përfundojnë në duart e gabuara ose në koshin e mbeturinave. Softueri uniFLOW i instaluar paraprakisht për printimin dhe menaxhimin në rrjet¹ shton veçori opsionale shtesë të sigurisë së IT-së, si identifikimi i përdoruesit me kartë aksesit.

¹ Softueri bazë uniFLOW përfshihet si standard. Funkcion opsional shtesë i disponueshëm për t'u blerë. Konsultohuni me përfaqësuesin tuaj të Canon.

² Jetëgjatësia ekonomike e pritshme e serisë colorWAVE është 7 vite duke u bazuar në të dhënat e shërbimit të Canon.



SMARTshield mbron të dhënat tuaja

Me teknologjinë SMARTshield, mund të mbështeteni në protokollet e sigurisë, parandaluesit e hakimit dhe enkriptimin e skedarëve për t'ju ndihmuar në mbrojtjen e të dhënave, qoftë atyre të ruajtura apo atyre në transferim e sipër. Asgjësimi i të dhënave dhe protokolle të tjera të fshirjes janë të disponueshme në mënyrë që të dhënat tuaja të mos aksesohen pasi të jenë fshirë.

Veçoritë e forta të identifikimit të përdoruesit të SMARTshield janë projektuar për t'ju ndihmuar në kalimin e dokumenteve vetëm në duart e përdoruesve që duhet të kenë akses në to. Mundësohet gjithashtu menaxhim i qartë dhe i besueshëm për kontrolluesit e buxhetit. Në përfundim, kur të jeni gati t'i thoni lamtumirë printerit tuaj colorWAVE seria T, mund të fshini ose madje të hiqni diskun e ngurtë.

Përditësime të sigurisë, tani dhe në të ardhmen, me mbështetje softuerike dhe shërbim në distancë

- Njoftime automatike për korrigjimet e sigurisë, për t'u instaluar sipas specifikimeve të administratorit
- Korrigjimet e sigurisë Microsoft do të jenë të disponueshme gjatë gjithë jetëgjatësisë ekonomike të serisë T²

Mbrojtje për vitet në vijim me SMARTshield CIP (Procesi i Vazhdueshëm i Përmirësimit)

- Ne monitorojmë vazhdimisht pikat e dobëta të sigurisë në kuadrin e gjerë të sigurisë për të përcaktuar nëse është nevoja të zbatohen korrigjime
- Një kompani e jashtme e këshillimit mbi sigurinë kryen testime të depërtimit në mënyrë të strukturuar, për të verifikuar efikasitetin. Testimi bazohet kryesisht në rreziqet kryesore të sigurisë së aplikacioneve sipas Projektit të Hapur Botëror të Sigurisë së Aplikacioneve (OWASP)



MË SHUMË
SE 85% E
PRINTERIT
MUND TË
RIPËRDORËT

MBËSHTETJE PËR NISMAT E QËNDRUESHME TË BIZNESIT PËR VITET NË VIJIM

colorWAVE seria T ju sjell printim kompakt, pa zhurmë dhe ergonomik. Është një sistem printimi me ngjyra mbi të cilin mund të mbështeteni për vitet e ardhshme për të përkrahur nismat tuaja të qëndrueshme të biznesit.



Seria T ju ndihmon të minimizoni gjurmën e karbonit të biznesit tuaj për një mjedis më të mirë sot dhe për një të ardhme të qëndrueshme. Teknologjia CrystalPoint me TonerPearls jo-toksike mbështet një mjedis të shëndetshëm pune me përdorim gati tërësisht pa pluhur dhe pa aroma. Fisheku i tejdukshëm ju mundëson të kontrolloni lehtësisht nivelin e tonerit, dhe asnjë TonerPearl nuk lihet pas në fishek.

Dizajni inteligjent i pjesëve të konsumueshme mbështet gjithashtu nismat tuaja të qëndrueshme të biznesit, si p.sh. ripërdorimi i paketimit të fishekut si kuti ruajtëse për mirëmbajtjen e tonerit.

colorWAVE T60 dhe T65 ofrojnë printime të certifikuar si Gold nga GREENGUARD, duke garantuar që janë të përshtatshëm për përdorim afër fëmijëve dhe grupeve tjera të ndjeshme. Printerët e serisë T janë të fortë dhe jetëgjatë, minimizojnë nevojën e riprintimit dhe lehtësojnë riciklimin me anë të heqjes së bojës të certifikuar si "e mirë".

colorWAVE seria T është projektuar për të qenë një koleg i mirë, duke mos emetuar ozon dhe duke bërë shumë pak zhurmë. Përdorimi i ulët i energjisë është certifikuar me etiketën ENERGY STAR për motorët e printerëve. colorWAVE seria T është certifikuar si Silver nga EPEAT, etiketa mjedisore më kryesore në botë për produktet elektronike.

SPORTEL UNIK PËR VITET NË VIJIM

Me colorWAVE seria T, profesionistët tanë të llogarive ju ndihmojnë të konfiguroni një zgjidhje tërësisht të integruar për formate të mëdha, me harduerë, softuerë, artikuj dhe shërbime nga një furnizues i vetëm.

Pa miksim të elementeve nga palë të treta. Përfitoni performancën që ju duhet dhe evitoni shqetësimet, falë një sistemi të integruar.

Mbështetja

Materiale dhe pjesë të konsumueshme

... për shitjet dhe
shërbimet



Përfundimi



Skanerët



Ekosistem i softuerëve të fluksit
të punës



**NJË SISTEM
TËRËSISHT I
INTEGRUAR**

Konfiguroni colorWAVE sipas nevojave tuaja

colorWAVE seria T është një printer vërtet "të gjitha në një", me skanim¹, printim dhe fotokopjim¹. Materialet dhe profilet e materialeve të testuara ofrojnë cilësi të jashtëzakonshme printimi ndërkohë që teknologjia Image Logic² me Scanner Express ndihmon në rritjen e cilësisë së skanimeve dhe fotokopjeve. Për sa i përket kapacitetit të materialeve, mund të konfiguroni colorWAVE për t'ju përshtatur produktivitetit dhe volumit tuaj të printimeve, me opsion deri në gjashtë rula, 42 inç gjerësi dhe 200 metra gjatësi për rul.

Përveç printerit, mund të zgjidhni nga një katalog elementesh dhe pajisjesh periferike me komunikim të pandërprerë në dy drejtime midis printerit, skanerit¹ dhe fëditorit¹. Ju nevojitet kapacitet skanimit shtesë? Përmirësoni produktivitetin me mekanizmin e pavarur për volume të larta Scanner Professional¹. Ose zgjidhni nga Stacker Select¹ dhe dosjet¹ që janë sintonizuar me printerin tuaj dhe që i përshtaten më mirë nevojave të biznesit tuaj.

Për çdo gjë, organizata e shitjeve dhe shërbimeve e Canon ju mbështet në çdo fazë të krijimit të dokumenteve dhe procesit të printimit. Mund të shijoni sportelin unik praktik me printim me ngjyra mbi të cilin mund të mbështeteni për vitet në vijim.

¹ Opsionale.

² E disponueshme në kombinim me mekanizmin opsional Scanner Express.



**NJË KATALOG
MBI TË ÇILIN
MUND TË
MBËSHTETENI**

Mohimi i përgjegjësise

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të kopjohet, modifikohet, riprodhohet ose transmetohet në ndonjë formë ose me ndonjë mjet, elektronik, manual, ose ndryshe, pa lejen paraprake me shkrim të Canon Production Printing. Ilustrimet dhe imazhet e nxjerra nga printeri janë simulime dhe nuk vlejnë domosdoshmërisht për produktet dhe shërbimet e ofruara në secilin treg vendas. Përmbajtja e këtij botimi nuk duhet të interpretohet si ndonjë deklaratë, garanci apo premtim në lidhje me vetitë specifike apo specifikimet, as të performancës teknike apo përshtatshmërisë për përdorime të veçanta. Përmbajtja e këtij botimi mund të ndryshohet herë pas here pa paralajmërim.

Adobe dhe Postscript janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të Adobe Incorporated. Microsoft dhe Microsoft Windows janë marka tregtare ose marka të regjistruara tregtare të grupit të kompanive Microsoft. uniFLOW® është markë e regjistruar tregtare e NT-ware Systemprogrammierungs-GmbH.

© 2024 Canon Production Printing Canon është markë e regjistruar tregtare e Canon Inc. colorWAVE dhe PRISMA janë marka të regjistruara tregtare të Canon Production Printing Netherlands B.V.

The Canon logo is displayed in a bold, red, serif font.